

<b>1. Titulli i projektit:</b>	Përforcimi i Rrjetit të Tensionit të Ulët 2014 – Dislokimi i njehsorëve  Distrikti i Gjilanit
<b>2. Përshkrimi i projektit:</b>	<p>Fushëveprimi i këtij projekti përfshin furnizimin me material, instalimin, testimin dhe komisionimin kryesisht të rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV të shpërndarjes në regjionet e Distriktit të Gjilanit. Projekti përfshin ndërtimin dhe komisionimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Linjave ajrore 10(20) kV;</li><li>• Rrjetin e Tensionit të Ulët 0,4 kV;</li><li>• Vendosjen e ormanëve jashtë oborreve të konsumatorëve dhe zhvendosjen e njehsorëve ( pikës matëse)</li></ul> <p><b>Arsyetimi:</b> Rrjeti i vjetruar i distribuimit të energjisë i trashëguar nga KEDS nuk garanton cilësi dhe siguri të furnizimit me energji. Si rrjedhojë e rrjetit të vjetruar dhe rritjes së numrit të konsumatorëve të amvisërisë (rezidencial) dhe komercial dhe rrjedhimisht rritjes së konsumit të energjisë, kapacitetet aktuale nuk i plotësojnë kriteret teknike dhe si pasojë cilësia e furnizimit deri tek konsumatori i fundit, nuk është në nivel të kënaqshëm dhe në kufijtë e kërkuar teknik.</p> <p>Për më tepër, rreth 1200 konsumatorë që do të ndikohen drejtpërdrejt nga ky projekt janë furnizuar përmes linjava të gjata dhe të vjetruara 0,4 kV dhe aktualisht janë duke u përballur me rënie të tensionit</p>

	<p>e sidomos gjatë orëve të pikut (shfrytëzimit maksimal) të energjisë elektrike.</p> <p><b>Objektivat e projektit janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kualitetit dhe rritja e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike;</li> <li>• Përkrahja e rritjes së ngarkesës;</li> <li>• Eliminimi i fyteve të ngushta;</li> <li>• Reduktimi i humbjeve teknike;</li> <li>• Reduktimi i rënieve të tensionit;</li> <li>• Reduktimi i orëve të humbura për konsumator (SAIDI, SAIFI). etj.</li> </ul>
<b>3. Data e fillimit:</b>	16 prill 2014
<b>4. Data e përfundimit:</b>	31 dhjetor 2014
<b>5. Kostoja e projektit</b>	0,3 milion €
<b>6. Sponsor i projektit:</b>	KEDS, Divizioni i Rrjetit
<b>7. Njësia Sponsor:</b>	Departamenti për Kontrollit të Investimeve



<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i projektit</b>	<b>Data e fillimit</b>	<b>Data e përfundimit</b>
1	TS 10/0,4kV Te pasqyra - Viti	28.04.2014	31.12.2014
2	TS 10/0,4kV Bregu i Thatë Gjilan	22.04.2014	31.12.2014